



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:151788

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05845106

KP.nr. 39/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “INFRAKOS” Sh.A, me seli në Fushë Kosovës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Flamur Spahiu, ndaj të paditurit “Victoria Invest internacial” Sh.p.k me NUI 810629230, me seli në Suharekë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Besnik Kuçi me seli në Suharekë, me objekt kontesti lirimit e pronës dhe pagesën e borxhit, jashtë seance më datën 21.06.2024 merr këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpapia –

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpapia e paditësit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infakos” Sh.a, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri Victoria Invest internacial” Sh.p.k., që paditësit ti paguaj në emër të qirasë për shfrytëzimin e pronës në sipërfaqe prej 480m<sup>2</sup>, sipas kontratës ne.19/669, për periudhën prej 22.03.2019 deri ë 31.03.2020 në shumë prej 3.915,20 euro me kamatë ligjore, si dhe të bëjë lirimit e pronës nga njerëzit dhe sendet dhe të njëjtën ti dorëzoj paditësit në gjendjen e mëparshme.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 22.07.2022 në Gjykatën Themelore Pejë Dega në Klinë, ka ushtruar padi ndaj të paditurit me kërkesë për lirimit e pronës dhe shpërblimin e dëmit, në të cilën ka theksuar se të paditurit i është dhënë në shfrytëzim prona e paditësit në afërsi të stacionit të hekurudhuave në sipërfaqe prej 480m<sup>2</sup>, sipas kontratës numër 19/669 e datës 22.03.2019 deri më datën 31.03.2020 me çmim 28.32 euro për metër katrorë në çmim të përgjithshëm prej

3.915,20 euro dhe gjithashtu ka kërkuar edhe lirimin e pronës dhe dorëzimi e të njëjtës pronarit në gjendjen e pranimit të së njëjtës.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitorë sipas padisë për datën 18.06.2024, e cila seancë nuk është mbajtur, pasi që me datën 12.06.2024 i autorizuari i paditësit me parashtrësë ka njoftuar gjykatën se paditësi po heqë dorë nga kërkesë padia dhe po e tërheqë padinë pasi që i padituri e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit dhe për këtë i ka bashkangjitur provë parashtrësës.

Sipas dispozitës së nenit 149.1, të LPK-së, përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heq dorë nga një pjesë e kërkesë padisë apo nga e gjithë kërkesëpadia gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykim në bazë të heqjes dorë)”*, ndërsa me pikën 2, të po të njëjtit nen shprehimisht përcaktohet *“për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës se paditur”*.

Bazuar në deklaratimet e të autorizuarit të paditësit se heqë dorë nga kërkesë padia dhe tërhiqet nga padia në tërësi sa i përket lirimit të pronës dhe pagesës së borxhit.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 149, lidhur me nenin 388, të LPK-së, gjeti se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore që gjykata të bie aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, në të cilin është përcaktuar se *“Secila palë paraprkishtë vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”*.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.39/23, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.